# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434759**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sllovakia i del sërish kundër BE-së, bllokon sanksionet ndaj Rusisë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/sllovakia-i-del-serish-kunder-be-se-bllokon-sanksionet-ndaj-rusise/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 11:01:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 10:58:08 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f92482e2e41ce105d9cdac1d29a821c509f9c626eac424323f76088418619ba0` |
| TEKSTI | `fafcf2ca432f8c65f63d59faf5e0ede96302e2311949825b45f753a2bbad0739` |
| PAMJA | `273ce45d5341ece7fd4f0148927343c756b79dba781a018aa475046a3615d8de` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `442abfc9e13a417240df52e5bd790b4f508b655002292456e282f312e8d739db` |
| E MËPARSHMJA | `5a3e647bf57c244ab178f3e7af5d77110024c948ecf44daddff73b3eb0507f40` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/442abfc9e13a417240df52e5bd790b4f508b655002292456e282f312e8d739db`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Sllovakia ka kundërshtuar sërish zgjatjen e sanksioneve të Bashkimit Europian ndaj Rusisë, duke kërkuar njëkohësisht që disa persona të hiqen nga lista e zezë e BE-së.

Bratislava kundërshtoi rinovimin e sanksioneve gjatë një takimi të përfaqësuesve të përhershëm të vendeve anëtare të BE-së në Bruksel, sipas agjencisë italiane të lajmeve *ANSA.*

27 vendet anëtare të Bashkimit Europian kanë kohë deri më 15 shtator për të arritur një marrëveshje, përpara se masat ndëshkuese të skadojnë. Çështja pritet të diskutohet sërish nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm, i njohur si *Coreper*, përpara përfundimit të afatit.

Sanksionet e BE-së ndaj Rusisë kërkojnë miratimin unanim të të gjitha vendeve anëtare dhe duhet të rinovohen periodikisht për të mbetur në fuqi.

Sllovakia kishte kundërshtuar më herët edhe një propozim për zgjatjen e sanksioneve për 12 muaj, në vend të gjashtë muajve. Sipas raportimeve, ajo ishte i vetmi shtet anëtar që kundërshtoi këtë propozim.

BE-ja kishte propozuar zgjatjen për 12 muaj me synimin për të shmangur negociatat e përsëritura çdo gjashtë muaj për vazhdimin e masave ndaj Moskës.

Pas debatit të mëparshëm, Ministria e Jashtme e Sllovakisë deklaroi se diskutimet për rishikimin e rregullt gjashtëmujor të sanksioneve po vazhdonin dhe se pritej të përfundonin deri më 15 shtator.

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.